

10 TE VERTETAT PER VANGJEL ZHAPEN

(1800 -19.06.1865)

Në librin e tij shterues, tashmë të mirënjohur dhe të lexuar nga të gjithë labovitët, Vangjel Zhapa, mirëbërësi i madh labovit(Tiranë,2003), Qirjako Hila na përcjell tekstualisht edhe përgjigjen e Konstandin Zhapës, kur i kërkuan në vitin 1890 informacione "mbi jetën dhe veprimtarinë e Vangjel Zhapës", që kishte vdekur një çerek shekulli më parë. Konstandin Zhapa përgjigjej: "duke mos pasur asnjë broshurë apo lloj tjetër informacioni në gjuhën rumune dhe duke parë se edhe ato që kishin shkruar në gjuhën greke nuk ishin ekzakt (të sakta F. M), do të desha të hartoja një material në gjuhën greke dhe ta vë në dispozicionin tuaj sa më shpejt" (N. Postolake, Lavdi Vangjel Zhapës, Rumani, 1996).

I nxitur nga shkrimi i Konstandinit dhe duke ndierë, si labovit dhe shqiptar, shqetësimin e tij që duket hapur në ato rrjeshta që kishte shkruar dy vjet para se të ndërronte jetë, në Nantes la Jolie (Francë), mbledha dhjetë të vërteta mbi jetën dhe veprimtarinë e Vangjel Zhapës, i sistemova kronologjikisht dhe po i paraqes.

E VERTETA E PARE: PERKATESIA ETNIKE

Vangjel Zhapa ka lindur në fshatin Labovë e Madhe, krahina e Rrëzës (Rrethi i Gjirokastrës), nga prindër shqiptarë vendës. I ati, Vasili, ishte nga familja Zhapa(fjalë e rëndomtë shqipe), ndërsa e ëma, Sotira, e kishte prejardhjen nga fisi Meksi. Emri i fisit Meksi mund ta ketë origjininën nga funksioni, ofiqi ose posti i kryetarit të tij që duhet të ketë qenë mjek, kurse prapashtesa - si tregon zotërim vendi, si edhe tek mbiemra të shumtë shqiptarë (Malasi, Bregasi, Shalsi etj.). Sipas profesor E. Çabej mund të ketë në themel fjalën mjek dhe më pas mjekës - mjekësi -Meksi, si nomen agentis (emër veprues) që është. Shumë nga Meksajt kanë ushtruar profesioinin e mjekut pas studimeve në universitetet më të shquara të kohës, por edhe si mjekë popullorë, duke e trashëguar këtë profesion nga të parët e tyre, që kanë qenë të famshëm në të gjithë Ballkanin.

Vangjel Zhapa pasi mbushi moshën 13 vjeç u largua nga fshati për në Janinë, ku u lidh me mjekun e famshëm popullor Petro Meksi, kushëri e së ëmës, i cili shërbente në gardën e Ali pashë Tepelenës. Në të vërtetë, njohuritë për njohjen, kultivimin dhe përdorimin e bimëve mjekësore i kishte marrë nga e ëma, që duket kishte parë tek i biri prirjen për mjekësinë popullore dhe vokacionin për të ndihmuar njerëzit e sëmurë dhe në nevojë, kurse Petro Meksi e stërviti për të ushtruar me sukses veçanërisht kirurgjinë. Të shumtë kanë qenë bashkëlufëtaret e tij gjatë betejave kundër turqve, që përfituan nga shërbimet e mjekut popullor Vangjel Zhapa. Pak vite më vonë, në Rumani, ishin sukseset e arritura gjatë ushtrimit të mjekësisë popullore, që do të përcaktonin të ardhmen e jetës së tij.

E VERTETA E DYTE: ARSIMIMI

Njohuritë e para arsimore i mori nga prifti i fshatit që kryente si zakonisht në atë kohë edhe rolin e mësuesit. Në Janinë u regjistrua në shkollën ushtarake për përgatitjen e kuadrove. Në këtë shkollë, që ishte hapur nga Ali pashë Tepelena, jipnin mësim pedagogë të ardhur nga vendet perëndimore. Atje janë përgatitur edhe shumë nga figurat e shquara të kryengritjes greke si: Andruco, Karaiskaqi, Varnajoti, Dhiakos, Gurras, Grivas, Bakallos, etj. (Shih Filip Liço: Probleme të marrëdhënieve greko-shqiptare, Tiranë, 2009, f. 92).

Vangjel Zhapa nuk ka shërbyer kurrë si ushtar, aq më tepër si mercenar i Ali pashë Tepelenës. Si oficer i ri që ishte, u emërua në kështjellën e fshatit Mazia që ndodhej në jug të Janinës dhe më pas (1820) u bashkua me suljotët, në atë kohë miq të Aliut, për të luftuar kundër turqve.

Nga mesi i viteve '30 thelloi njohuritë agronomike duke kryer studimet përkatëse në Paris. Pasi u kthye në Rumani, zbatoi me sukses metodat e reja që ritën dukshëm rendimentet bujqësore në pronat e tij.

E VERTETA E TRETE: VANGJEL ZHAPA, ITHTAR I ALI PASHE TEPELENES

Pas dështimit të përpjekjeve për formimin e një shteti të madh shqiptar, në përbërjen e të cilit do të ishte edhe pjesa veriore e Shqipërisë, me qartësinë e një politikani të shquar të kohës, Ali Pasha u përpoq ta bashkërendonte kryengritjen kundër Stambollit me lëvizjet çlirimtare të popujve të Ballkanit, duke e parë këtë si të vetmen rrugë drejt lirisë. "Aliu kishte filluar një bashkëbisedim me agentin rus, grekun Jan Paparigopulos, i cili shkoi në Sankt-Petërsburg me mision për të përgatitur një plan, për një kryengritje të përbashkët të shqiptarëve dhe grekëve, që do të udhëhiqesh nga Ali Pasha (Gabriel Meksi, Ali Pashë Tepelena, Arkivi Institutit Historisë, A-III-169, 1950). Në librin e Aravantinos Historia e Ali Pashë Tepelenës, f. 28, cituar nga Gabriel Meksi, shkruhet se "shumë prej udhëheqësve ushtarakë grekë (Aleksis Navos, Odhise Andruco etj.), i sugjeruan Aliut të marrë kryesinë e lëvizjes, që do të kish për qëllim shkapëputjen e Shqipërisë dhe të Greqisë nga Perandoria Osmane".

Në rast fitoreje, Aliu do të krijonte një shtet monarkik konstitucional shqiptar të përbërë nga zotërimet shqiptare dhe nga Thesalia, në krye të të cilit do të vihej vetë, kurse Greqia qendrore dhe Moreja, do të formonin një shtet autonom, i cili do të vihej nën protektoratin e tij (Historia e popullit shqiptar, I, 2002, f. 665).

Aliu dërgoi njerezit e tij në Vienë për të parë nga afër modelin e Perandorisë Austriake konstitucionale dhe shumëkombëshe, duke dashur ta kishte si shëmbull për shtetin e ardhshëm shqiptaro-grek, që synonte të krijonte bashkë me ithtarët e kësaj ideje. Për këtë fakt ka shkruar në revistën e tij Albania më 1902 edhe Faik Konica, që ka gjetur në kujtimet e princit Jozef Meternik, kancelari i atëhershëm i Perandorisë Austriake, shënimin e mëposhtëm: "Ali pashë Tepelena më dërgoi më 3 mars 1822 një njeri të besës me një letër për të bërë një konstitucion për

Shqipërinë" (Albania shih Vepra, Tiranë, 1993, cituar tek F. Pouquville, Ali Tepelena, Tiranë, 2009, f. 528).

Vangjel

Zhapa, oficer në ushtrinë e Ali pashë Tepelenës, u përfshi plotësisht në këtë projekt që kishte hartuar Aliu së bashku me këshilltarët e tij shqiptarë. Dhimitër Shuteriqi ka shkruar: "Vangjel Zhapa, që kishte shërbyer që shumë i ri tek Ali pashë Tepelena dhe i kishte mbetur këtij besnik gjer në fund, ishte me sa duket, në krye të herës, për një shtet shqiptaro-grek ku shqiptarët të loznin rolin e madh që loste Aliu" (Dhimitër Shuteriqi, Gjurmime letrare, 1974, f. 246).

E VERTETA E KATERT: 5 PLAGET QË VAZHDONIN TE DHEMBNIN

Pas shkatërrimit të shtetit të Ali pashë Tepelenës, Vangjel Zhapa i përfshirë në repartet kryengritëse greke nën udhëheqjen e Xhavellës, Boçarit, Gurras, Zervës etj., luftoi nga dita e parë deri në të fundit dhe kudo u dallua si hero (Revista Epirotiqi Eteria, Athinë, 1996. Cituar nga Qiriako Hila tek Vangjel Zhapa, mirëbërës i madh labovit, f.13).

Vangjel Zhapa morri pjesë në kryengritjen greke, si edhe dr. Vangjel Mexi, mjeku i Ali pashë Tepelenës, përkthyesi i Dhjatës së Re në shqip, bashkë me mijëra shqiptarë të tjerë, të bindur se me çlirimin e Greqisë do të shpejtohej edhe çlirimi i Shqipërisë.

"Pas luftës i dhanë vetëm medaljen e argjendë të luftimeve në vijën e parë të frontit dhe disa toka në Verios, afër Selenikut, ku kishte si komshi turq të egërsuar që e shikonin me dyshim dhe urrejtje" (N. Postolake, Lavdi Vangjel Zhapës, Bukuresht, 1996, cituar nga Q. Hila, f.15).

Në këto kushte braktisi Greqinë e ngushtë, tërë male të thata dhe mosmirënjohëse, për fushat pa fund dhe pjellore të Rumanisë, ku e priste edhe një koloni e madhe shqiptarësh.

Iku nga Greqia me zemër të thyer. Për dhjetë vjet nuk rreshti së kërkuari gradat dhe medaljet që meritonte. Më në fund dhe pikërisht në vitin 1843, d.m.th. 13 vjet pas përfundimit të luftës në Greqi, "sipas dy diplomave të mbretit Otton, që mbajnë datat 6. 3. 1843 dhe 18/30 qershor 1843, Vangjel Zhapës i jepet grada kapiten falange"(komandant kompanie)(Shkresë e Ministrisë së Jashtëme greke, datë 3.12 .1890, cituar nga Q. Hila, f.13).

Vangjel Zhapa u ofendua edhe më tepër nga shkalla e ulët e gradave që i dha mbreti Otton dhe thellësisht i prekur, dërgon letrën e fundit ku nxjer në pah sakrificat e tij gjatë viteve të luftës dhe ankohet për vlerësimin e pamjaftueshëm që i ishte bërë nga autoritetet greke të kohës.

Ja përmbajtja e shkurtuar e letrës:

"Që nga viti 1821 deri në 1830 i shërbeva ndershmërisht atdheut tim si ushtarak. Më parë në drejtimin e Marko Boçarit, me Vejkon dhe Zervën. Pastaj kalova në Pallona nën drejtimin e Panajasë dhe Gurras në të gjitha luftërat e Greqisë Lindore dhe më pas, nën udhëheqjen e kapedan Kiço Xhavellës

Në gjithë këtë periudhë morra pesë plagë, shënjat e të cilave duken edhe sot në trupin tim, ndërsa nëna ime plakë, me urdhër të Vezirit Qutahi më 1825 u rrëmbye, u soll e lidhur në Janinë dhe u fut në burgun e nëndheshëm për dy vjet.

Për sa më sipër mund të dëshmojnë ata që u bënë heroj nga lufta si Xhavella etj.

Nga të gjitha këto luftëra dhe sakrificat u shpërbleva vetëm me medaljen e argjendë të luftëtarëve të vijës së parë.....

Por që të mos gëzoj gradën time që më takon e konsideroj veten të dënuar padrejtësisht dhe i respektuari ynë mbret, asnjëherë nuk do ta fali këtë padrejtësi" (Epirotiqi Eteria, Athinë,1990).

Ishte viti 1845, kishte kaluar shumë kohë, por qeveritarët grekë nuk kishin harruar se Vangjel Zhapa, përveçse shqiptar, kishte qënë edhe përkrahës i zjartë i idesë për një shtet të madh shqiptarogrek, ku do të ishin shqiptarët që do të udhëheqnin.

Letra e përmendur më sipër nuk do të kishte përgjigje, kurse Vangjel Zhapa, ende jo shumë i pasur, do të mbetej vetëm një kapiten falange në lirim.

E VERTETA E PESTE: VANGJEL ZHAPA, ME I PASURI NE EVROPEN LINDORE

Ky njeri energjik, largëpamës, i vendosur dhe me njohuri të thella, jo vetëm në bujqësi, por edhe në ekonominë në përgjithësi, u emërua këshilltar në oborin e mbretit të Rumanisë.

Falë njohurive agroteknike moderne dhe aftësive drejtuese, pasuria e tij shtohej në mënyrë marramendëse. Fshatari nga Labova dhe mjeku popullor u shndrua në një latifondist me të ardhura financiare të pallogaritshme. Veçse, ai dallohej nga të tjerët edhe për klasën dhe sjelljen elegante, mënyrën evropiane të jetës që bënte dhe shoqërinë e tij të zgjedhur që përfshinte edhe princa e mbretër. Rezidenca e tij afër Bukureshtit përmendej, jo vetëm si vend i darkave madhështore që shtroheshin dhe i shampanjës e i verave franceze nga më cilësoret që shërbeheshin pa kursim, por edhe për bibliotekën madhështore, unike në Rumani.

Pasuria e pa fund që grumbulloi, ia shtoi edhe më shumë fisnikërinë, duke i ngjallur gjithashtu pasionin për të ndihmuar të varfërit kudo që ishin dhe për të dhënë dhurime me përmasa të mëdha dhe të zgjedhura me shumë kujdes.

E VERTETA E GJASHTE: EUREKA OSE RRUGA PER ATHINE

Vangjel Zhapa ishte magjepsur që nga koha e shkollës nga kultura, arti, historia, letërsia dhe qytetaria helene. Tashmë me një pasuri që vlerësohej 6 milionë flori, kishte vendosur që pas Rumanisë, të materializonte idetë e tij edhe në Greqi, që vazhdonte të treguhej e ftohtë me të.

Në fillim të vitit 1856 i propozon qeverisë greke se ishte i gatshëm të mbështeste moralisht dhe materialisht ringjalljen e lojrave olimpike të lashtësisë. Ai do të dhuronte me këtë rast medaljet e arta për sportistët fitues, të cilat do t'ua dorëzonte personalisht.

Ministri i jashtëm grek Rangavis i përgjigjet jo pa sarkazëm: "Sot kombet nuk dallohet nga atletët dhe vrapuesit më të mirë, por nëpërmjet kampionëve në industri, artizanat dhe agrikulturë (N. Postolake, Lavdi Vangjel Zhapës, Bukuresh, 1996. Cituar nga Q. Hila).

Zhapa, mishërimi i kampionit më të sukseshëm për kohën, me urtësi dhe durim zhvilloi një korespondencë të dendur me Rangovis që zgjati dy vjet me rradhë, por më kot. Qeveria greke nuk lëvizte nga pozicioni i saj.

Duke ditur tashmë se çdo gjë ka një çmim, biznesmeni Vangjel Zhapa nga Labova i drejtohet mbretit Otton, duke i ofruar qeverisë greke si dhuratë 400 aksione të shoqërisë rumune të lundrimit, mijëra monedha flori, përveç medaljeve të arit për fituesit e garave të Olimpiadës.

Qeveria greke dhe mbreti Otton nuk mund të rezistonin karshi kësaj oferte. Këto dhurata bënë të mundur që të dalë menjëherë dekreti i veçantë mbretëror që pranonte dhuratat dhe ngarkonte një komision të posaçëm me ministrin e brendshëm në krye, për organizimin e garave dhe ekspozitave.

Garat që u organizuan në nëntor 1859 në rrugët e Athinës dhe jo në stadiumin e vjetër, për rikonstrukcionin e të cilit Zhapa kishte dhënë një shumë tjetër të madhe të hollash, dështuan. Vetë Vangjel Zhapa vendosi në kokën e fituesit kurorën e lavdisë. Kjo ishte hera e parë dhe e fundit që ai shkeli tokën greke, që pas përfundimit të luftës kundër turqëve më 1830.

Edicionet e tjera u zhvilluar normalisht në vitet 1870, 1875, 1889. Veçse Zhapa, i sëmurë që nga viti 1862, ndërroi jetë më 1865.

E VERTETA E SHTATE: NJE QENDRIM I NEVERITSHEM.....

Për kontributin e madh që dha Zhapa për Lojrat Olimpike dhe jo vetëm, shteti grek i ndërtoi një shtatore përjetësimi që u vendos në të majtë të hyrjes qendrore të pallatit që do të mbante emrin Zappeion, ndërkohë që emri i tij u shkrua, bashkë me emrat e burrave më të mëdhenj të Greqisë, në sallën e parlamentit.

Pas vdekjes së tij, qeveritarët grekë të kohës, bashkë me pasurinë lakmonin edhe Vangjel Zhapën si personalitet poliedrik, hero i kryengritjes greke dhe pasaniku më i madh i Evropës Lindore. Veçse, Zhapën e donin grek, me origjinë greke, me prindër grekë, i lindur në një fshat që ndodhej në një krahinë greke. Pra ata donin Labovën dhe Rrëzën greke edhe pse është një krahinë e vendosur thellë në tokat shqiptare.

Kështu paraqitet fatkeqësisht Vangjel Zhapa jo vetëm në botime të ndryshme greke, por edhe në gjuhë të tjera. Përkatësia e tij qind për qind shqiptare dhe karakteri i pastër etnik shqiptar i krahinës

së tij mjegullohen me formulime si "Vangjel Zhapa është me origjinë greke dhe ka lindur në Labovë, një fshat i Epirit të Veriut", duke lënë të kuptohet se vinte nga një krahinë greke.

Në të vërtetë "Epiri i Veriut nuk ka ekzistuar dhe nuk ekziston si toponim i një teritori të caktuar gjeografik" (Filip Liço, Probleme të marrëdhënieve greko-shqiptare, Tiranë, 2009, f.108). "Epiri i Veriut lindi historikisht në fund të lufrave ballkanike si një term politik që lidhet me konjunkturën politiko-ushtarake, diplomatike dhe strategjike në atë kohë, kur secili nga vendet ballkanike synonte të merrte sa më shumë teritore nga Perandoria Turke e larguar nga Ballkani" (Po aty f. 158). Pra në kohën që jetonte V. Zhapa (1800-1865) ende nuk ishte sajuar Vorio Epiri, kurse për turqit ai, si çdo i krishterë shqiptar, ishte kaur (grek) sikurse çdo mysliman ishte turk." Këto emërtime janë kapërcyer me kohë dhe përdorimi i tyre në ditët tona tregon varfërinë e argumentave prej autorëve të tyre" (Po aty f. 160), meqënëse "identifikimi i ortodoksëve shqiptarë me etninë greke është krejtësisht i gabuar. Ortodoksë në Ballkan janë edhe sërëbet, edhe bullgarët, edhe rumunët" (po aty, f. 167)

"Sot, në fillim të shekullit 21, të flitet me gjuhën e shekujve të kaluar është e papercptueshme. Me pretendime të tilla nuk mund të ketë kurrë marrëdhënie të sinqerta miqësie dhe bashkëpunimi midis Greqisë dhe Shqipërisë", përfundon minoritari i urtë grek Filip Liço, në librin e tij Probleme të marrëdhënieve greko-shqiptare (f. 166).

... DHE TE VERTETAT PER LABOVEN E MADHE DHE LABOVITET

Këto teori të djallëzuara dhe pa asnjë bazë shkencore që u fabrikuan para mesit të shekullit XIX, çuditërisht vazhdojnë edhe në ditët tona dhe pse modeli për argumentimin e autoktonisë së shqiptarëve buron drejtëpërdrejtë nga studimi i zakoneve të banorëve të Rrëzës, "fshatrat në krahun e djathtë të lumit Drino, para bashkimit të tij me Vjosën" (Hahn, Studime Shqiptare, Jena, 1853, f.175), të cilat janë përzgjedhur nga shkencëtari i madh gjerman Johann Georg von Hahn dhe shqiptari dr. Apostol Meksi" nga që i përkasin një zone të pastër nga pikpamja etnografike, larg ndikimeve greke sllave dhe aq më tepër turke" (Cabej N., Autoktonia e shqiptarëve në studimet gjermane. Tiranë. 1990, f. 79).

Labovitët dhe gjithë banorët e Rrëzës, krenar për origjinën dhe të dashuruar pas gjuhës së tyre të bukur, kanë dhënë një ndihmesë të madhe për lëvrimin dhe futjen e saj në kisha dhe në shkolla. I pari në këtë drejtim shkëlqeu dr. Vangjel Meksi (1770-1823), mjeku i Ali pashë Tepelenës, që pasi hartoi gramatikën shqipe, e para nga autorë shqiptarë(para vitit 1819), përpiloi alfabetin origjinal që përmbante edhe shkronja neolatine, hartoi drejtëshkrimin e gjuhës shqipe, si dhe shqipëroi veprat e francezit Fleuri me format teksti për nxënësit shqiptarë(1814), duke përfunduar me kryeveprën e tij, shqipërimin e plotë të Dhjatë së Re (1821).

Fill pas tij spikat Vangjel Zhapa (1800-1865), që i shtyrë nga dashuria për popullin e tij dhe për gjuhën shqipe, bëri të mundur mësimin e saj në shkollat me dy klasë gjimnaz që i ngriti vetë(1860), si dhe në shkollat fillore greke që funksiononin në Shqipërinë e Jugut. Ai mbështeti financiarisht Naum Veqilharxhin për botimin e abetareve të para shqipe(1844, 1845) dhe bëri të mundur nxjerrjen e fermanin për hapjen e shkollave shqipe në Shqipërinë e Jugut.

Përbri Vangjel Zhapës duhet vendosur leklioni Anastas Byku, që ushtroi aktivitetin patriotik në periudhën 1848-1878 dhe nuk rreshti së theksuari se," megjithë ndarjet fetare dhe krahinore, populli shqiptar përbënte një njësi kombëtare më vete". Ai ishte kryeredaktor gazetës së parë në shqip Pellazgu, që kishte karakter të theksuar patriotik dhe subvencionohej nga miku i tij i familjes V. Zhapa. Kjo gazetë shërbeu për të zgjuar dhe orientuar polemikën e zjarrtë që zhvillohej në gjirin e inteligjencës shqiptare në fund të viteve '50 të shekullit XIX në Shqipëri dhe jashtë saj. Me dhurimet e V. Zhapës botoi Gramë për shqiptarët. Ai hartoi gjithashtu projektin për krijimin e një sistemi të veçantë për arsimin në Shqipëri(1860).

E jashtëzakonshme ka qënë veprimtaria patriotike e dr.Apostol Meksit(1825-1869). Ai, duke ndihmuar Hahn-in për të mësuar më mirë gjuhën shqipe, e njohu edhe me traditat e zakonet familjare të vendlindjes së vet dhe të krahinës së Rrëzës. Hahn-it i tërhoqën vëmendjen rrëfimet e tij dhe e ngarkoi të kryejë mbledhjen dhe përshkrimin e plotë të tyre. Këtë material studimor Hahn-i e botoi në veprën e mirënjohur Albanesische Studien (Studime Shqiptare). Me këtë përshkrim dr. A. Meksi del si studiuesi i parë shqiptar në fushën e etnografisë.

Vazhduesi i punës së rilindasve labovitë dr. Dhimitër Apostol Meksi, ishte njëkohësisht lëvruesi i gjuhës shqipe, mbledhës i folklorit dhe materialeve etnografike në Camëri, përkthyes i klasikëve Grekë në shqip dhe arkeolog.

Këta rilindas të vërtetë i kanë shërbyer atdheut duke rruajtur dinjitetin dhe identitetin kombëtar në periudhën më të vështirë, kur pushtuesit osmanë dhe shovinistat fqinjë përgatiteshin t'a eliminonin atë, duke krijuar dhe përhapur në mënyrë obsesive teori të shumta të djallëzuara.

I jashtëzakonshëm ka qënë edhe aktiviteti i politikanëve labovitë gjatë fundit të shekullit XIX dhe fillimit të shekullit XX, duke filluar nga Petro Meksi, komisar i Lidhjes së Prizrenit për jugun dhe luftëtar në luftën e Vlorës, Jorgji Meksi (1860-1942), gazetari revolucionar që shkruante se "nuk janë vetëm shkollat që do na ndajnë nga Turqia, por edhe baruti", dhe Kristo Meksi (1849-1930), që pas një veprimtarie të dëndur patriotike në Rumani, shoqëroi Ismail Qemalin për në Vlorë, ku si deputet i Gjirokastrës, firmosi dokumentin final të Shpalljes së Pavarësisë.

E rëndësishme ka qënë veprimtaria patriotike e mësuesve labovitë Nane Panajot Meksi (1862-1937) dhe Vasil Konomi, që, të mbështetur nga vëllezërit Illo dhe Vangjel Noçka dhe pothuajse nga gjithë bashkësia labovite (94 nga 100 familje që banonin në Labovë), kapërcyen pengesat e shumta të ngritura nga Mitropolia e Gjirokastrës dhe autoritetet turke, dhe në 10 Prill 1910 hapën shkollën e parë shqipe në rrethin e Gjirokastrës.Ata gjithashtu përkthyen Apostollin për ta thënë shqip në kishën e Labovës.

Besoj se do të gjejë mirëkuptimin e bashkëfshatarëve të mi që të rreshtoj, bashkë me labovitët e shquar edhe Vangjel Maksin (1903-1983), autor i librit Labova në shekuj (1970) që paraqet përpjekjet titanike të labovitëve për futjen e gjuhës shqipe në kisha dhe shkolla, ngjarje këto që rojnë edhe sot në kujtesën historike të popullit tonë si dëshmi e tij për të ruajtur identitetin dhe dinjitetin kombëtar, gjuhën amtare dhe kulturën shqiptare.

Duke i hedhur një vështrim historisë së popullit tonë dhe veprimtarisë dhe rolit të labovitëve në të, del qartë që, sa herë Shqipëria është ndodhur në udhëkryq, ose i është dashur të kryej sforcime maksimale për të dalë nga situata të vështira që rezikonin lirinë ose progresin e vendit, labovitët si edhe gjithë banorët e Rrëzës, kanë dhënë kontributin e tyre të vyer me penë ose pushkë.

Në fillim të shekullit XIX labovitët u vendosën pranë Ali pashë Tepelenës në mbështetje të synimit të tij për të krijuar shtetin shqiptar të pavarur. Komuniteti labovit vazhonte i bashkuar edhe në mes të shekullit XIX, kur nxiste dhe mbështeste Vangjel Zhapën për futjen edhe të shqipes në shkollën e tij të Labovës, ose kur Nane Panajot Meksi me shokë hapën në 10 prill 1910 shkollën e parë shqipe.

Me formimin e Shtetit shqiptar, shumë labovitë të diplomuar në universitetet e Evropës, u kthyen në Shqipëri dhe u vendosën në Tiranë, kryeqyteti i atdheut dhe vunë në shërbim të tij aftësitë profesionale, ndershmërinë dhe patriotizmin për ndërtimin dhe funksionimin e një shteti të lirë në shëmbullin e demokracive perëndimore.

Pushtimi i Shqipërisë nga Italia fashiste shpërtheu edhe një herë vokacionin për liri të labovitëve dhe të gjithë banorëve të Rrëzës. Fshatrat e

Rrëzës u shndruan në qendra të rëndësishme për organizimin e rezistencës kundër nazi-fashistëve. Shumë të rinj nga Rrëza u rreshtuan në repartet partizane dhe luftuan me trimëri deri në çlirimin e vendit. Veçse, flladin e lirisë nuk mundën ta gëzonin ata të rinj nga Labova dhe nga fshatrat e tjera të Rrëzës, që ranë me armë në dorë, duke kryer detyrën ndaj atdheut. Veprën e tyre e nderon sot me respekt i gjithë populli shqiptar.

Me çlirimin e vendit banorët e Rrëzës u mobilizuan plotësisht për rindërtimin dhe zhvillimin e vendit, sidomos në administratën shtetërore, sistemin juridik, arsim, shkencë, ushtri, mjekësi, bujqësi etj. Të shumtë ishin banorët e Rrëzës që u përfshinë në proceset demokratike të vendit që filluan gjatë dhjetëvjeçarit të fundit të shekullit 20.

Labovitët si dhe gjithë banorët e Rrëzës janë krenarë për origjinën e tyre shqiptare. Ata kanë folur vetëm shqip, madje në dialektin më të pasur dhe më të bukur të toskërishtes, siç shprehen studiuesit Lik e Hahn dhe janë përpjekur gjatë shekujve, më shumë nga shqiptarët e tjerë, për lëvrimin e gjuhës shqipe dhe futjen e saj në kisha dhe shkolla.

E VERTETA E TETE: VANGJEL ZHAPA DHE LEVRIMI I GJUHES SHQIPE

Vangjel Zhapën, edhe pse i larguar prej kohësh nga Shqipëria, e gjejmë në disa dokumente që vërtetojnë se gjatë viteve '40, qëndronte shumë pranë Naum Veqilharxhit në Rumani dhe "kishte diskutuar me javë të tëra lidhur me alfabetin e tij" (Aleks Buda, Studime historike, Tiranë, 1965, 2, f. 60).

Andrej Ibagovu në librin e tij Carte de alegere nënvizon: " Rreth viteve 1844 Vangjel Zhapa dhe dr.Arsaqi, të nxitur nga bashkëatdhetari i tyre Naum Veqilharxhi, kishin vendosur të mbështetnin një

lëvizje për kulturë kombëtare. Naum Veqilharxhi kishte përgatitur një abetare në gjuhën shqipe, një gramatikë dhe libra të tjerë didaktikë. Zhapa dhe Arsaqi e dërguan në Stamboll me letra rekomandimi për shtypjen e librave dhe nxjerjen e një fermi me anë të cilit të lejohej hapja e shkollave në gjuhën shqipe.

Librat u shtypën menjëherë, fermi doli dhe librat u dërguan në Shqipëri" (A. Ibagovu, Carte de alegere, Bukuresht, 1887, f.119-120, cituar nga Myslim Islami tek N. Veqilharxhi, Tiranë, 1977, f. 119-120).

Nikolla Naço(1843-1913), atdhetar dhe veprimtar i dalluar i Rilindjes Shqiptare, ka dëshmuar se:"Vangjel Zhapa me dr. Arsaqin darovitën respektivisht 25,000 dhe 10,000 flori për gjuhën shqipe dhe punuan së bashku me N. Veqilharxhin për të shkruar gjuhën shqipe dhe për të shtypur shumë kartëra" (Nikolla Naço, Gaz.Shqiptari, Bukuresht, 23. 10. 1888, cituar nga Dh. Shuteriqi, Gjurmime Letrare , f. 246).

Librat e N. Veqilharxhit që panë dritë nëpërmjet dhurimeve të Zhapës, janë "ëvetari" (1844) dhe "Fare i ri ëvetar shqip" (1845),d.m.th. dy abetaret e para të gjuhës shqipe. Me këta libra dhe me idetë e shprehura në ta nga N. Veqilharxhi, hapet programi kulturor-gjuhësor i Rilindjes Kombëtare dhe hidhen hapat e parë të arsimit shqip.

Në vitin 1860 V. Zhapa shprehet hapur se "shqipja mund të shkruhet për nevojat e përdorimit familjar, por edhe si mjet për të fituar më shumë dije" (Gaz. Elpis, Athinë, 5.11.1860) (cituar nga Dh.Shuteriqi, Naum Veqilharxhi, në Gjurmime letrare, Tiranë 1974, f. 229).

Vangjel Zhapa mbështeti financiarisht Anastas Bykun për botimin e gazetës patriotike Pellazgu, gazeta e parë në gjuhën shqipe si dhe gramatikën "Gram për shqiptarët" më 1861, që u përdor në shkollat e tij, ku siç dihet u mësua edhe shqipja përveç greqishtes.

E VERTETA E NENTE: VANGJEL ZHAPA DHE SHKOLLAT E TIJ KU MESOHEJ EDHE SHQIPJA

Vangjel Zhapa edhe pas vdekjes së Naum Veqilharxhit, vazhdoi të jetë aktiv në drejtim të problemeve të shumta lidhur me Shqipërinë, shqiptarët, gjuhën shqipe dhe futjen e saj në shkolla. Në frymën e porosive të Naum Veqilharxhit u shtrua në mënyrë propagandistike se "nëqoftëse nuk e mësojmë një popull në gjuhën e tij amtare, nuk është e mundur ta edukojmë atë".

"Për të arritur këtë qëllim, ishte hartuar një program i gjerë veprimtarish, që do të realizohej kryesisht me mbështetjen financiare të Vangjel Zhapës, i cili prej kohësh kishte dhuruar të holla për mbajtjen e shkollave në fshatrat e rretheve të Gjirokastrës, Tepelenës, Përmetit, etj." (A. Buda, Studime Historike, Tiranë 1965, 2, f. 99).

Sipas programit të hartuar nga Vangjel Zhapa dhe Anastas Byku, që do të ishte inspektor i shkollave të Zhapës në Labovë dhe gjetkë, parashikohej:

- botimi në shkallë të gjerë i librave shkollorë në gjuhën shqipe

- hapja e shkollave fillore në shqip për vajza dhe djem, mundësisht në çdo fshat

- ndërtimi i gjimnazeve në Gjirokastrë, Përmet, i një liceu në Berat, si dhe i dy shkollave të mesme për vajza në Rrëzë dhe Labovë

(Pellazgu, 25.5.1859 dhe 24.12.1860).

Në gazetën Pellazgu, 1. 3. 1861, A. Byku boton një artikull ku vë në dukje se: "V. Zhapa prej kohësh kishte dhuruar të holla për mbajtjen e shkollave në rrethin e Përmetit, Gjirokastrës, Tepelenës etj.. Në njërin nga këto shkolla, në Labovën e Zhapës, nuk mësohej vetëm greqisht, por edhe shqip, si mjet ndihmës".

Po në gazetën Pellazgu, Vangjel Zhapa shkruan një artikull" ku vë në dukje veprimet e veta në favor të shkollave në Shqipëri, ku ka futur edhe shqipen". (A.Buda, Të dhëna mbi lëvizjen kombëtare shqiptare në vitet 1859-1861, Studime Historike, 2, 1965),

Dh. Shuteriqi shkruan : " Zhapa ndihmoi vërtet për futjen e shqipes në shkollat greke"(Dh. Sh.,Gjurmime letrare, Tiranë,2 ,1974, f. 247).

Në një periudhë shumë të vështirë për shqiptarët, kur Perandoria Osmane dhe Mbretëria e Greqisë shtuan përpjekjet e tyre për të zhdukur gjuhën dhe kombësinë e popullit tonë, ndërkohë që Lëvizja Kombëtare Shqiptare qëndronte në nivelin më të ulët, ishte vetëm laboviti Vangjel Zhapa, që, me energjinë dhe pasurinë e tij, bëri të mundur që shqiptarët të mësonin gjuhën amtare jo vetëm në shkollat që ndërtoi vetë, por edhe në qindra shkolla greke që funksiononin kudo në Shqipërinë e Jugut.

Vetëm pas disa dhjetëvjeçarësh dhe pikërisht në fund të shekullit të XIX, lufta për mësimin e gjuhës shqipe do të zinte një vend qëndror në programin politik dhe kulturor të Rilindjes Kombëtare.

E VERTETA E DHJETE: VANGJEL ZHAPA PARARENDES I QYTETAREVE TE EVROPES SE BASHKUAR

Labovitët e të gjithë brezave që jetojnë sot, krenarë për origjinën e tyre të lashtë dhe të lidhur ngushtësisht me atdheun, gjithmonë protagonistë kur përcaktohen fatet e tij, prej kohësh kanë shprehur trishtimin e tyre për faktin se Vangjel Zhapa, ka ndarë dashurinë e tij edhe me dy vende të tjera. Ai ka qenë nënshkruar rumun gjatë pjesës më të madhe të jetës dhe Rumaninë e quante atdheu i adoptuar, kurse atdhe quante edhe Greqinë, megjithëse fjalët më të ëmbla do t'i shprehte për vendlindjen e tij, Labovën, si "atdhe të veçantë" ose "vendi i shenjtë ku takohej me Zotin".

V. Zhapa kujtohet dhe nderohet me respekt në Rumani, pasuritë e tij të shumta kanë lumturuar dhe vazhdojnë t'i lumturojnë grekët, ndërsa ne shqiptarët, të drejtuar keq nga historiografia jonë, vazhdojmë të mos e shohim në 360 gradë figurën e tij poliedrike dhe bëhemi xhelozë me popujt e tjerë të Ballkanit që, në kohën kur jetonte bashkëfshatari ynë milioner, ishin në gjendje të thithnin investimet dhe donacionet e shumta që ofronte ky bamirës shqiptar i jashtëzakonshëm.

Krahas parave të shumta që dhuronte, me delikatesën që e karakterizonte, ai kishte gjithashtu kapacitetet e duhura të shpërndante paqe, dashuri dhe mirëkuptim midis popujve, duke u integruar plotësisht në historinë e kulturës, të zhvillimit ekonomik dhe të qytetërimit panballkanik të mesit të shekullit XIX.

Shqiptarët e sotëm, kanë filluar ta kuptojnë dhe ta pranojnë bashkëfshatarin e tyre, me eshtra që i prehen në dy varre të ndryshme, ashtu si ishte ai në të vërtetë, dhe ta konsiderojnë tashmë si qytetarin pararendës të Evropës së Bashkuar, të cilën po përgatitemi, më në fund, ta prekim edhe ne.

Fedhon Mexsi